



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Në: KSC-BC-2020-06

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratorja: Fidelma Donlon

Data: 21 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Titulli i dosjes: Kërkesë për caktimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës

Klasifikimi: Konfidencial dhe *ex parte*

VENDIM

mbi kërkesën për caktimin e vendit të procedurës në shtetin pritës

Gjykatësit të procedurës paraprake:
Gjykatës Nikola Giju

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Xhek Smith

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në përputhje me nenin 3(6) dhe (8)(a) dhe (d) të Ligjit Nr. 05/L053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), nenin 3 të Marrëveshjes me Shtetin Pritës¹ dhe rregullën 82(3) të Rregullores së Procedurës dhe Provave ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim për caktimin e vendit të procedurës në shtetin pritës për procedurat e filluara sipas nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullën 86 të Rregullores për të gjitha procedurat dhe çështjet e tjera që burojnë të lidhura me to.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 prill 2020, Prokurori i Specializuar e njoftoi Kryetaren, në pajtim me rregullën 86(1) të Rregullores, për procedurat që do të fillojnë në pajtim me nenin 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(2) të Rregullores, dhe kërkoi caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake në pajtim me nenin 33(1)(a) të Ligjit.
2. Në të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi gjykatësin Nikola Giju si gjykatës të procedurës paraprake në çështjen aktuale.²

II. VENDI I ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS

3. Duke marrë parasysh parashtrimet³ e Prokurorit të Specializuar dhe hetimet e tij në kryerje e sipër, Kryetarja gjykon se situata aktuale e sigurisë dhe administrimi i duhur i drejtësisë e bëjnë të nevojshme caktimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës. Ky caktim i vendit të zhvillimit të procedurës ka të bëjë me procedurat e kryera në këtë çështje sipas nenit 38(4) të Ligjit, rregullës 86 të Rregullores, si dhe të

¹ Marrëveshja midis Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Kosovës në lidhje me Vendosjen e Institucionit Gjyqësor të Specializuar të Zhvendosur të Kosovës në Holandë, 1 janar 2017 (Marrëveshja me Shtetin Pritës).

² F00001, Vendimi për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake, 23 prill 2020 (konfidencial).

³ F00002, para. 4.

gjitha procedurat e tjera dhe çështjet e tjera që burojnë lidhur me to. Kjo siguron zhvillim të efikas, të efektshëm dhe të sigurt të këtyre procedurave.

III. KLASIFIKIMI I VENDIMIT

4. Meqenëse vendimi aktual u referohet parashtrimeve që aktualisht janë klasifikuar si konfidenciale, dhe hetimet e Prokurorit të Specializuar si dhe procedurat para gjykatësit të procedurës paraprake vazhdojnë të jenë konfidenciale *ex parte*, ky vendim mban të njëjtin klasifikim. Vendimi aktual mund të riklasifikohet në një datë të mëvonshme, në pajtim me rregullat 82 dhe 84 të Rregullores, nëse arsyet për klasifikimin aktual pushojnë së ekzistuari.

PËR KËTO ARSYE, KRYETARJA

CAKTON vendin e zhvillimit të procedurës në shtetin pritës për procedurat në këtë çështje të zbatuara sipas nenit 38(4) të Ligjit, rregullës 86 të Rregullores, si dhe të gjitha procedurat dhe çështjeve të tjera që burojnë lidhur me to; dhe

KËRKON nga Administratorja që të marrë çdo hap të nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

nënshkrimi

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E hënë, 21 shtator 2020

Në Hagë, Holandë